



Prishtinë, 20 qershor 2012

Kodi i ZRRE: V_406_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke marrë parasysh:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së); dhe
- Aplikacioni i KEK-ut për të Hyrat dhe Tarifat e Lejuara

Në mbledhjen e mbajtur më datë 20 qershor e nxori këtë:

VENDIM

TË APROVOJË TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR) që do të mblidhen nga tarifat dhe taksat e rregulluara e që do të aplikohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për vitin relevant (tarifor) prej 12 muajve nga 1 prill 2012 deri më 31 mars 2013.

Arsyetim

- I. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjetike e Kosovës SH.A. (KEK) aplikacionin për aprovim të MAR-it që duhet mbledhur nga OSSH-ja nga tarifat dhe taksat e rregulluara që do të hyjnë në fuqi nga 1 qershori 2012.
- II. Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga OSSH, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike 2012(SHTE6) – Raport konsultativ, KEK Sh.A,
 - Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike 2012(SHTE6) – Shqyrtimi i komenteve, përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së, lëshuar më 20 qershor 2012.
- III. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të përmendura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- IV. MAR që do të mbulohet nga OSSH-ja e licencuar për periudhën prej 12 muajve nga 1 prill 2012 deri më 31 mars 2013 është **68,729,796 euro**.
- V. OSSH-ja përmes këtij Vendimi udhëzohet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së, brenda 45 ditëve të datës së vendimit, metodologjinë për vendosjen e tarifave dhe ngarkesave të rregulluara për mbulimin e MAR-it të përcaktuar me këtë Vendim, në përputhje me nenin 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.14 i Ligjit mbi Energjinë Elektrike nr. 03/L-201.
- VI. Pas aprovimit të metodologjisë, OSSH-ja do t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së tarifat dhe taksat e propozuara të rregulluara për mbulimin e MAR-it me këtë vendim dhe me metodologjinë e aprovuar.
- VII. OSSH-së do t'i lejohet të mbulojë, në vitet në vazhdim, çdo diferencë në mes të MAR të përcaktuar me këtë vendim dhe atë që do të mbulohet përmes tarifave dhe taksave të rregulluara të aprovuara, aty ku kjo diferencë është për tarifat dhe taksat e rregulluara që aprovohen për të hyrë në fuqi në një datë më vonë se 1 prill 2012.
- VIII. Ky vendim është lëshuar në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbizotëroj versioni i gjuhës shqipe
- IX. Ky vendim hyn në fuqi në datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë para Gjykatës kompetente kundër këtij vendimi brenda katërbëdhjetë (14) ditëve pas marrjes së saj apo publikimit të saj në ueb faqen e ZRRE-së, cilado të ketë ndodhur e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar